



FLETORJA ZYRTARE

E

REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

Nr.59

2005

21 korrik

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.510, datë 30.6.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të ushtarakëve të sistemit të Ministrisë së Rendit Publik, të sistemit të Ministrisë së Drejtësisë dhe të sistemit të Ministrisë së Pushtetit Vendor dhe të Decentralizimit”, të ndryshuar.....	2177
Vendim i KM nr.511, datë 30.6.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit”, të ndryshuar.....	2179
Vendim i KM nr.512, datë 30.6.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave “Për pagat dhe shtesat mbi pagë të ushtarakëve të shërbimit pyjor”, të ndryshuar.....	2180
Vendim i KM nr.513, datë 13.5.2005	Për rritjen e masës së shpërblimit të veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar.....	2181
Vendim i KM nr.514, datë 30.6.2005	Për një ndryshim në vendimin nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave “Për pagat e punonjësve të tatimeve”, të ndryshuar	2182
Vendim i KM nr.521, datë 8.7.2005	Për miratimin e marrëveshjes së koncesionit të formës“BOO” ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Ekonomisë, dhe shoqërisë “Cement Factory” sh.p.k., për shfrytëzimin e një sipërfaqeje përreth fabrikës së çimentos, Fushë-Krujë.....	2183
Vendim i KM nr.522, datë 8.7.2005	Për transferimin e fondeve financiare të kreditorëve të shoqërive huamarrëse në administrim nga llogaritë bankare të Raiffeisen	

	Bank sh.a., te Banka Kombëtare Tregtare.....	2192
Vendim i KM nr.524, datë 8.7.2005	Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme dhe të kulturave të ndryshme bujqësore, pronë private, që preken nga lidhja me sistemin e nënstacionit 220/110 kV, Rrashbull.....	2193
Vendim i KM nr.525, datë 8.7.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.96, datë 24.2.1997 të Këshillit të Ministrave “Për pagesën e të punësuarve të portit detar Durrës, të cilët dalin të papunë, si pasojë e zbatimit të projektit të rristrukturimit të këtij porti”, të ndryshuar.....	2195
Vendim i KM nr.532, datë 9.6.2005	Për disa ndryshime në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave “Për strukturën dhe pagat e punonjësve të Policisë së Ndërtimit”, të ndryshuar.....	2195
Udhëzim i MF nr.12, datë 30.3.2005	Për disa ndryshime dhe plotësime në udhëzimin “Për tarifat e lejimit, regjistrimit dhe pagesat e verifikimit dhe kalibrimit të mjeteve matëse dhe rregullat e zbatimit të tyre”.....	2199
Vendim i IIPPS nr.1, datë 1.7.2005	Për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare.....	2200
Vendim i IIPPS nr.2, datë 1.7.2005	Për dhënien e lejes për ushtrimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare.....	2201
Vendim i ERE nr.26, datë 27.5.2005	Për dhënien e licencës për prodhimin e energjisë elektrike për shoqërinë “Favina” sh.p.k. për centralin e Vithkuqit.....	2202
Vendim i ERE nr.27, datë 27.5.2005	Për miratimin e formularit standard të paraqitjes së një ankese në ERE.....	2202
Vendim i ERE nr.28, datë 24.6.2005	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit.....	2203
Vendim i ERE nr.29, datë 24.6.2005	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike.....	2203
Vendim i ERE nr.30, datë 24.6.2005	Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes të klientët tariforë.....	2204
Vendim i ERE nr.31, datë 24.6.2005	Për shfuqizimin e vendimit nr.6, datë 23.5.2002 “Për procedurat e vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara”.....	2204
Vendim i ERE nr.32, datë 18.7.2005	Për zbatimin e rregullave të miratuara nga ERE për faturimin e energjisë elektrike dhe kryerjen e shërbimeve ndaj konsumatorit..	2204
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të vdekur të shtetasit Mehmet Hasan Reçaj.....	2205
	Vendim i shkurtuar për shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Muda.....	2205

VENDIM
Nr.510, datë 30.6.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.54, DATË 27.2.1992 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR TRAJTIMIN ME PAGË DHE SHITESA MBI PAGË TË
USHTARAKËVE TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË RENDIT PUBLIK, TË SISTEMIT TË
MINISTRISË SË DREJTËSISË DHE TË SISTEMIT TË MINISTRISË SË PUSHTETIT
VENDOR DHE TË DECENTRALIZIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.54, datë 27.2.1992 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

1. Në rreshtin e tretë dhe në atë të pestë, të paragrafit të tretë të pikës 1, fjala “... së Përgjithshme...”shfuqizohet.

2. Lidhjet nr.1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit ushtarakë të Gardës së Republikës”, nr.2 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit ushtarakë të Policisë së Burgjeve” dhe nr.3 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit ushtarakë të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe Shpëtimit”, zëvendësohen me lidhjet, me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhen këtij vendimi dhe janë pjesë përbërëse të tij.

3. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i pashpërndarë i pagave, sipas nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

LIDHJA NR.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKË TË GARDËS
SË REPUBLIKËS

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	11 800
2.	II	12 000
3.	III	12 250
4.	IV	12 500
5.	V	12 800
6.	VI	13 100
7.	VII	13 300
8.	VIII	13 700
9.	IX	14 500
10.	X	15 300
11.	XI	15 750
12.	XII	16 200
13.	XIII	17 700

14.	XIV	18 500
15.	XV	19 300
16.	XVI	20 000
17.	XVII	20 850
18.	XVIII	23 300
19.	XIX	25 650
20.	XX	28 900
21.	XXI	32 150
22.	XXII	40 600

LIDHJA NR.2

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKË TË POLICISË SË BURGJEVE

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	11 800
2.	II	12 000
3.	III	12 250
4.	IV	12 500
5.	V	12 800
6.	VI	13 100
7.	VII	13 500
8.	VIII	13 800
9.	IX	14 200
10.	X	14 500
11.	XI	14 800
12.	XII	15 200
13.	XIII	15 500
14.	XIV	15 800
15.	XV	16 100
16.	XVI	16 500
17.	XVII	17 000
18.	XVIII	19 000
19.	XIX	21 500
20.	XX	24 000
21.	XXI	28 000
22.	XXII	38 000

LIDHJA NR.3

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKË TË POLICISË SË MBROJTJES NGA ZJARRI DHE SHPËTIMIT

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	11 800
2.	II	12 000
3.	III	12 250
4.	IV	12 500
5.	V	12 800
6.	VI	13 100
7.	VII	13 300
8.	VIII	13 700
9.	IX	14 500
10.	X	15 300
11.	XI	15 750
12.	XII	16 200
13.	XIII	17 700
14.	XIV	18 500
15.	XV	19 300
16.	XVI	20 000
17.	XVII	20 850
18.	XVIII	23 300
19.	XIX	25 650
20.	XX	28 900
21.	XXI	32 150
22.	XXII	40 600

VENDIM

Nr.511, datë 30.6.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” dhe “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, niveli më i ulët i pagës (Klasa I), për punonjësit e Policisë së Ndërtimit të bëhet 11 800 lekë në muaj.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i pashpërndarë i pagave, në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.512, datë 30.6.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.185, DATË 16.4.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT DHE SHITESAT MBI PAGË TË USHTARAKËVE TË SHËRBIMIT PYJOR”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.185, datë 16.4.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit ushtarakë të shërbimit pyjor”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i pashpërndarë i pagave, në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LIDHJA NR.1

PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT USHTARAKË TË SHËRBIMIT PYJOR

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	11 800
2.	II	12 000
3.	III	12 250
4.	IV	12 500
5.	V	12 800
6.	VI	13 100
7.	VII	13 500
8.	VIII	13 800
9.	IX	14 200
10.	X	14 500
11.	XI	14 800
12.	XII	15 200
13.	XIII	15 500
14.	XIV	16 000
15.	XV	16 300
16.	XVI	16 700
17.	XVII	17 000
18.	XVIII	18 000
19.	XIX	19 000
20.	XX	20 000
21.	XXI	22 000
22.	XXII	24 000
23.	XXIII	28 000

VENDIM

Nr.513, datë 13.5.2005

**PËR RRYTJEN E MASËS SË SHPËRBLIMIT TË VETERANËVE TË LUFTËS
ANTIFASHISTE NACIONALÇLIRIMTARE TË POPULLIT SHQIPTAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8 të ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të neneve 21 e 27 të ligjit nr.8379, datë 29.7.1998 “Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së

Shqipërisë”, dhe të nenit 7 të ligjit nr.9339, datë 23.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpërblimi i veteranëve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, i përcaktuar në vendimin nr.190, datë 3.5.1995 të Këshillit të Ministrave “Për zbatimin e ligjit nr.7874, datë 17.11.1994 “Për statusin e veteranit të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar”, të ndryshuar, të rritet në masën 2.2 për qind, duke arritur vlerat si më poshtë vijnë:

- Shpërblimi sipas shkronjës “a” të pikës 7, nga 3166.2 (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë dy) lekë në muaj bëhet 3235.8 (tre mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë tetë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas shkronjës “b” të pikës 7, nga 2535.4 (dy mijë e pesëqind e tridhjetë e pesë pikë katër) lekë në muaj bëhet 2591.1 (dy mijë e pesëqind e nëntëdhjetë e një pikë një) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas shkronjës “c” të pikës 7, nga 2110.4 (dy mijë e njëqind e dhjetë pikë katër) lekë në muaj bëhet 2156.8 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas shkronjës “e” të pikës 7, nga 632.8 (gjashtëqind e tridhjetë e dy pikë tetë) lekë në muaj bëhet 646.7 (gjashtëqind e dyzet e gjashtë pikë shtatë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas pikës 8/1, (për kohën e vuajtjes në burg mbi 6 muaj) nga 1054.7 (një mijë e pesëdhjetë e katër pikë shtatë) lekë në muaj bëhet 1077.9 (një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë nëntë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas pikës 8/2, (për kohën e vuajtjes në burg nga 1 deri në 6 muaj) nga 632.8 (gjashtëqind e tridhjetë e dy pikë tetë) lekë në muaj bëhet 648.7 (gjashtëqind e dyzet e tetë pikë shtatë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas shkronjës “a” të pikës 9, nga 3166.2 (tre mijë e njëqind e gjashtëdhjetë e gjashtë pikë dy) lekë në muaj bëhet 3235.8 (tre mijë e dyqind e tridhjetë e pesë pikë tetë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas shkronjës “b” të pikës 9, nga 2110.4 (dy mijë e njëqind e dhjetë pikë katër) lekë në muaj bëhet 2156.8 (dy mijë e njëqind e pesëdhjetë e gjashtë pikë tetë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas pikës 11, nga 1054.7 (një mijë e pesëdhjetë e katër pikë shtatë) lekë në muaj bëhet 1077.9 (një mijë e shtatëdhjetë e shtatë pikë nëntë) lekë në muaj.

- Shpërblimi sipas pikës 13, nga 42 243 (dyzet e dy mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë bëhet 43 172 (dyzet e tre mijë e njëqind e shtatëdhjetë e dy) lekë.

2. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, në buxhetin e miratuar për vitin 2005, t’i shtohet fondi prej 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekësh, për mbulimin e shpenzimeve, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi.

3. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.

4. Ngarkohen Ministri i Mbrojtjes, Ministri i Financave dhe Instituti i Sigurimeve Shoqërore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1.1.2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.514, datë 30.6.2005

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR.437, DATË 3.9.1993 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE “PËR PAGAT E PUNONJËSVE TË TATIMEVE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të shkronjave “ç” e “dh” të nenit 5/1 të ligjit nr.8487, datë 13.5.1999 “Për kompetencat për caktimin e pagave të punës”, të ndryshuar, dhe të nenit 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin dhe të Ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.437, datë 3.9.1993 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, lidhja nr.1 “Paga bazë sipas klasave për punonjësit tatimorë”, zëvendësohet me lidhjen me të njëjtin numër dhe

emërtim, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Efektet financiare për paga e sigurime shoqërore, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga fondi i pashpërndarë i pagave, në bazë të përcaktimit të bërë në nenin 8 të ligjit nr.9339, datë 21.12.2004 “Për Buxhetin e Shtetit të vitit 2005”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 gusht 2005.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

LIDHJA NR.1
PAGA BAZË SIPAS KLASAVE PËR PUNONJËSIT TATIMORE

Nr. rendor	Klasa	Paga bazë mujore në lekë
1.	I	11 800
2.	II	12 000
3.	III	12 300
4.	IV	12 700
5.	V	13 100
6.	VI	13 900
7.	VII	14 200
8.	VIII	14 500
9.	IX	15 600
10.	X	17 100
11.	XI	17 800
12.	XII	18 300
13.	XIII	19 100
14.	XIV	19 700
15.	XV	20 200
16.	XVI	20 700
17.	XVII	21 000
18.	XVIII	21 500
19.	XIX	21 800
20.	XX	23 500
21.	XXI	26 000
22.	XXII	28 000

VENDIM

Nr.521, datë 8.7.2005

**PËR MIRATIMIN E MARRËVESHJES SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOO”
NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE, PËRFAQËSUAR NGA MINISTRIA E
RREGULLIMIT TË TERRITORIT DHE E TURIZMIT DHE MINISTRIA E EKONOMISË
DHE SHOQËRISË “CEMENT FACTORY” SHPK, PËR SHFRYTËZIMIN E NJË
SIPËRFAQEJE PËRRETH FABRIKËS SË ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 9 e 10 të ligjit nr.7973, datë 26.7.1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit dhe të Ministrit të Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e marrëveshjes së koncesionit, të formës “BOO” (ndërtim-pronësi-shfrytëzim),

ndërmjet Këshillit të Ministrave, përfaqësuar nga Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Ekonomisë, si Organ Shtetëror i Autorizuar (OSHA), sipas vendimit nr.85, datë 11.2.2005 të Këshillit të Ministrave dhe shoqërisë “Fushë-Krujë Cement Factory” sh.p.k., për shfrytëzimin e një sipërfaqeje prej 16 ha, përreth fabrikës së çimentos, Fushë-Krujë, si propozim i pakërkuar i kësaj shoqërie, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit dhe Ministria e Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

MARRËVESHJE KONCESIONI

E FORMËS BOO PËR SHFRYTËZIMIN E NJË SIPËRFAQEJE PËRRETH FABRIKËS SË ÇIMENTOS, FUSHË-KRUJË

Marrëveshje e datës..... 2005 ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, përfaqësuar nga Organi Shtetëror i Autorizuar, Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, emëruar me vendim të Këshillit të Ministrave nr.85, datë 11.2.2005, këtu më poshtë e quajtur “OSHA”,

dhe

Fushë-Krujë Cement Factory sh.p.k., një shoqëri e pavarur, e organizuar sipas ligjeve të Shqipërisë, e regjistruar në Regjistrin Tregtar Shqiptar me vendimin nr.24373, datë 10.9.2000 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me seli në Fushë-Krujë, këtu më poshtë i quajtur “Koncesionari”, në lidhje me një koncesion të formës BOO, bazuar në ligjin nr.7973, datë 26 korrik 1995 “Mbi koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet publike dhe infrastrukturë” dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.85, datë 11.2.2005 “Për fillimin e procedurës së dhënies me koncesion të formës BOO, të një sipërfaqeje përreth fabrikës së çimentos, Fushë-Krujë”, për ndërtimin, pronësinë dhe shfrytëzimin mbi një sipërfaqe toke pranë fabrikës së çimentos për ndërtimin e furrës së re, këtu më poshtë i quajtur “Projekti”.

Këtu më poshtë, palët e sipërpërmendura do të quhen bashkërisht “Palët” dhe veçmas “Pala”

Duke pasur parasysh që:

1. Qeveria shqiptare konsideron zhvillimin e sektorit të prodhimit të materialeve të ndërtimit në Shqipëri, si dhe të industrisë për prodhimin e çimentos, si një prioritet të lartë në kuadër të zhvillimit të përgjithshëm të ekonomisë së vendit;

2. Qeveria shqiptare është angazhuar në zhvillimin e një tregu në të cilin prodhimi dhe tregtimi i materialeve të ndërtimit është i pranueshëm si ekonomikisht, ashtu edhe ekologjikisht, si dhe në përputhje me parimet e njohura dhe të pranuara të ekonomisë së tregut dhe me ligjet;

3. Qeveria shqiptare ka inkurajuar pjesëmarrjen e investitorëve vendas dhe të huaj, si dhe sipërmarrësve nga sektori privat, për ndërtimin dhe shfrytëzimin e impianteve të infrastrukturës në sektorin e prodhimit të materialeve të ndërtimit;

4. Qeveria shqiptare është e autorizuar, në bazë të ligjit, të zbatojë një sistem koncensionesh, përfshirë formën BOO të koncensionit, i cili bën të mundur ndërtimin dhe shfrytëzimin e objekteve industriale, pa financimin e Buxhetit të Shtetit;

5. Qeveria shqiptare ka marrë nga koncesionari një kërkesë për koncesion të formës BOO për projektin e mëposhtëm, si dhe ka shqyrtuar kërkesën në mënyrë të hollësishme dhe në përputhje me ligjet e zbatueshme dhe me parimet administrative, duke pasur në konsideratë interesin përkatës si lokal, ashtu dhe kombëtar;

6. Qeveria shqiptare e konsideron projektin të një rëndësie kombëtare dhe për rrjedhojë mendon se kërkesa duhet të merret në konsideratë nga Qeveria si një propozim i pakërkuar në përputhje me nenin 7 të ligjit për koncesionet;

7. Me anë të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.85 të datës 11 Shkurt 2005 — i botuar në Fletoren Zyrtare nr.8, datë 21 shkurt 2005 — ka dhënë miratimin për fillimin e procedurave për dhënien e një koncesioni të formës BOO për projektin, si një propozim jo i kërkuar, dhe ka emëruar Ministrinë e Ekonomisë dhe Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, si Organ Shtetëror

të Autorizuar (OSHA) për të negociuar dhe realizuar një marrëveshje për krijimin e një koncesioni të tillë;

8. Koncesionari ka shfaqur interes të konsiderueshëm për të investuar në industrinë e prodhimit të çimentos në Shqipëri dhe për shitjen e saj si brenda ashtu dhe jashtë Shqipërisë;

9. Koncesionari është i përgatitur të bashkëpunojë për këtë qëllim, me të tjera palë njësor të interesuara, në varësi të marrëveshjeve për terma reciprokisht të pranueshëm;

10. Koncesionari ka kapacitetin e domosdoshëm teknik, financiar dhe administrues për të ndërmarrë projektin, siç tregohet nga dokumentet e paraqitura nga ana e tij, dhe aftësinë për të realizuar projektin në përputhje me standardet ndërkombëtare;

11. Koncesionari ka paraqitur në Ministrinë e Ekonomisë kërkesën për një koncesion të formës BOO, bazuar në një propozim jo të kërkuar në lidhje me ndërtimin e projektit, përmes një letre nr.165 të datës 26.10.2004;

12. Koncesionari po kryen studime, në lidhje me impaktin mjedisor dhe social të projektit, në përputhje me kërkesat ligjore dhe sipas standardeve të njohura ndërkombëtare;

13. Koncesionari ka siguruar financimet e nevojshme për të investuar në ndërtimin e projektit;

14. Ka marrë miratimin për të përdorur sipërfaqen e tokës për të ndërtuar projektin, nëpërmjet vendimit të sipërpërmendur të Këshillit të Ministrave të Shqipërisë nr.85 të datës 11 shkurt 2005;

Prandaj, duke pasur parasysh kushtet dhe angazhimet e ndërsjella të parashtruara më tej në këtë Marrëveshje, dhe me qëllimin për të lidhur këtë Marrëveshje, Palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Përkufizime

1. Në këtë Marrëveshje, fjalët e mëposhtme do të kenë kuptimin që u është dhënë këtu:

Marrëveshje koncesioni: Ky dokument, si dhe shtojcat A, B, C dhe... bashkëngjitur tij.

Ligji i koncesionit: Ligji nr.7973 i datës 26 korrik 1995 “Për koncesionet dhe pjesëmarrjen e sektorit privat në shërbimet dhe infrastrukturën publike”, siç është amenduar deri në datën e kësaj Marrëveshjeje (domethënë nga ligji nr.8105 i datës 28 mars 1996, dekreti nr.1628 i datës 17 tetor 1996 dhe nga ligji nr.8329 i datës 16 prill 1998).

Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA): Ministria e Ekonomisë dhe Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit, emëruar me vendim të Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë nr.85, datë 11 shkurt 2005.

Koncesionari: Fushë Krujë Cement Factory sh.p.k.

Fabrika: Linja e re e prodhimit të çimentos me mjediset ndihmëse, e cila do të ndërtohet pjesërisht në truallin në pronësi të koncesionarit dhe pjesërisht në sipërfaqen prej 16 ha që do të vihet në dispozicion nga shteti shqiptar objekt i kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

Projekti: Zhvillimi, planifikimi, financimi, projektimi, ndërtimi, pronësia, shfrytëzimi i fabrikës mbi sipërfaqen e marrë me koncesion.

Plani i projektit: Skicat dhe specifikimet teknike për fabrikën e re të çimentos, si dhe parametrat kryesorë të punës, siç janë përshkruar në nenin 3 (1) dhe shtojcën A ose përpunuar siç është parashikuar aty.

Plani i investimit dhe plani i biznesit: Plani i përgatitur nga koncesionari për financimin e investimit dhe funksionimit të fabrikës, siç është përshkruar në termat bazë në shtojcën B.

Modifikim projekti: Një ndryshim ose përshtatje në karakteristikat e fabrikës ose specifikimet teknike të fabrikës, në krahasim me parametrat e parashtruar në nenin 3 (1) më poshtë dhe në shtojcën 1, brenda kufijve të fushës së veprimit të parashikuar në nenin 4 më poshtë.

Terreni: Sipërfaqja ose sipërfaqet prej 16 ha në të cilat ndodhet ose do të ndodhet çdo pjesë e fabrikës ose strukturave që i përkasin asaj, dhe në të cilat kryhen veprimtaritë ose shërbimet që janë pjesë e ndërtimit, shfrytëzimit dhe mirëmbajtjes së fabrikës (pa përfshirë sipërfaqen e tokës në pronësi të koncesionarit), siç tregohet në termat bazë në shtojcën D të kësaj Marrëveshjeje.

Punime: Ndërtimi dhe ngritja e fabrikës duke përfshirë punime, shërbime dhe materiale të nevojshme për projektimet dhe punimet inxhinierike, ekzekutimin, furnizimin me mjete si elektromekanike, ashtu edhe të tjera dhe kryerjen e punimeve civile të cilat janë pjesë e fabrikës

dhe/ose, sipas kontekstit, fabrika e ndërtuar dhe e përfunduar në një kohë të caktuar.

Kontrata: Çdo kontratë e lidhur nga koncesionari ose për furnizimin me shërbime, materiale dhe pajisje dhe interesa të tjerë, me qëllim përfundimin e fabrikës ose kryerjen e punimeve të tjera të projektit.

Vënia në dispozicion e terrenit: Vënia në dispozicion të koncesionarit e terrenit përreth fabrikës së çimentos Fushë-Krujë, që do të konfirmohet nga një protokoll i nënshkruar ndërmjet koncesionarit dhe OSHA-së.

Fillimi i punimeve: Fillimi i punimeve në terren për ndërtimin e fabrikës, që do të konfirmohet nga një protokoll i nënshkruar ndërmjet koncesionarit dhe OSHA-së.

Përfundimi i fabrikës: Përfundimi i punimeve, në mënyrë që fabrika të jetë gati për veprimtari tregtare.

Veprimtari tregtare: Gjendja në të cilën fabrika është funksionale për prodhimin e çimentos.

Leje të zbatueshme: Të gjitha vendimet, lejet, autorizimet, miratimet dhe aprovimet që duhet të merren dhe të disponohen, sipas ligjeve përkatëse në lidhje me zhvillimin, projektimin, financimin, prokurimin, ndërtimin, shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e projektit gjatë kohëzgjatjes së kësaj Marrëveshjeje.

2. Kjo Marrëveshje shoqërohet nga këto shtojca, të cilat përbëjnë një pjesë integrale të Marrëveshjes:

- Shtojca A: Plani i projektit
- Shtojca B: Plani i investimit dhe plani i biznesit
- Shtojca C: Përdorimi i truallit
- Shtojca D: Raport paraprak i vlerësimit të impaktit mbi mjedisin

Neni 2

Objekti dhe qëllimi i Marrëveshjes së koncesionit

1. Objekt i kësaj Marrëveshjeje është shfrytëzimi i sipërfaqes përreth fabrikës së çimentos në Fushë-Krujë, në bazë të planit përfundimtar të projektit të zhvilluar dhe finalizuar në përputhje me kushtet e Marrëveshjes nëpërmjet ndërtimit, pronësisë dhe shfrytëzimit të fabrikës për prodhimin e materialeve të ndërtimit.

2. Nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje koncesioni, OSHA, e autorizuar rregullisht nga Këshilli i Ministrave i Shqipërisë sipas ligjit për koncesionet, i jep koncesionarit një koncesion të formës BOO për ndërtimin, pronësimin dhe shfrytëzimin e sipërfaqes për fabrikën e çimentos, siç është përcaktuar më tej në këtë Marrëveshje.

3. Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje është të rregullojë këtë koncesion dhe të garantojë zbatimin e projektit nga ana e koncesionarit, lidhur me shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës për ndërtimin e fabrikës, në përputhje me termat dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje, si dhe të afirmojë dhe të parashikojë të drejtat dhe detyrimet e koncesionarit dhe ato të OSHA-së, në emër të Qeverisë së Shqipërisë, në kuadrin e një bashkëpunimi të ngushtë dhe reciprok ndërmjet palëve.

Neni 3

Karakteristikat e fabrikës

1. Karakteristikat kryesore të fabrikës janë:

Një linjë e re e prodhimit të çimentos “Linja e furrës 1” me një kapacitet 1.33 milionë tonë në vit çimento Portland duke përdorur procesin e thatë, sipas standardit europian tipet e mëposhtme të çimentos : CEM (25% të prodhimit dhe CEM II (75% e prodhimit).

Linja është e përbërë nga një furrë, e cila është e projektuar të garantojë një prodhim prej 3300 tonë në ditë klinker dhe të operojë jo më pak se 310 ditë në vit, i cili është ekuivalent me 1.33 milionë

tonë çimento Portland në vit.

Neni 4

Modifikime dhe përmirësime

1. Gjatë fazës së projektimit të detajuar inxhinierik të fabrikës dhe fazës së zbatimit të projektit, koncesionari mund të bëjë dhe është i autorizuar të bëjë disa modifikime në lidhje me shfrytëzimin e sipërfaqes së tokës, të cilat mund të jenë të domosdoshme për të përmirësuar fizibilitetin ekonomik të projektit dhe efikasitetin e fabrikës, ashtu si edhe për të përfutur një optimizim të fabrikës nga pikëpamja teknologjike dhe mjedisore.

2. Ndryshimet e projektit sipas paragrafit të mësipërm duhet t'i njoftohen paraprakisht OSHA-së me shkrim.

Neni 5

Detyrat e koncesionarit

1. Koncesionari është i detyruar që brenda 30 ditëve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje koncesioni të krijojë një shoqëri koncesionare.

2. Koncesionari është i detyruar të respektojë kushtet e kësaj Marrëveshjeje dhe merr përsipër ta zbatojë projektin në përputhje me to.

3. Koncesionari është i detyruar t'u bindet të gjitha ligjeve në fuqi.

4. Koncesionari është i detyruar të gjejë ose të sigurojë të gjithë financimin e nevojshëm për projektin, pa pjesëmarrje apo mbështetje financiare nga OSHA, dhe OSHA-ja nuk do të ketë asnjë detyrim financiar në lidhje me projektin, përveçse nëse parashikohet në mënyrë specifike në këtë Marrëveshje.

5. Koncesionari do të mundësojë financimin e investimit për realizimin e projektit përmes financimit me kredi të marrë nga institucione financiare, ku bëjnë pjesë banka ndërkombëtare për zhvillim dhe/ose institucione bankare tregtare të mirënjohura të rangut ndërkombëtar.

6. Koncesionari ka filluar punimet për ndërtimin e fabrikës në pjesën e tokës në pronësi të tij dhe do të vazhdojë kryerjen e punimeve në terren në përputhje me projektin e përgatitur.

7. Në mënyrë të veçantë, koncesionari pranon detyrimet si vijon:

a) Të mbledhë të gjitha të dhënat dhe informacionin e nevojshëm për shfrytëzimin e sipërfaqes.

b) Të zhvillojë dhe ta përfundojë projektimin dhe ndërtimin e fabrikës, bazuar në planin e projektit, në përputhje me standardet e përparuara bashkëkohore.

c) Të mbajë të informuar herë pas here OSHA-në në lidhje me ecurinë e punimeve dhe në lidhje me ngjarje të rëndësishme që kanë ndikim mbi punimet ose zbatime të tjera të projektit.

d) Si punëdhënës, në bazë të kontratave në lidhje me punimet dhe zbatime të tjera të projektit, të sigurojë që nënkontraktorët të zbatojnë kushtet dhe afatet e kësaj Marrëveshjeje.

e) Të zbatojë dhe/ose të sigurojë zbatimin e të gjitha rregullave në lidhje me sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, si dhe në lidhje me marrëdhëniet punëdhënës - punëmarrës sipas ligjeve në fuqi.

f) Të zbatojë ose të bëjë të mundur që të zbatohen gjatë kryerjes së punimeve të gjitha masat e duhura për mbrojtjen e jetës dhe sigurisë së punëtorëve dhe të të punësuarve, si dhe palëve të treta, të shmangë çdo ndarje ose dëmtim të paautorizuar të pronës publike ose private dhe të zbatojë të gjitha rregullat e përgjithshme dhe udhëzimet teknike që janë në fuqi, për parandalimin e aksidenteve në punë.

g) Të vendosë dhe të sigurojë vazhdimisht masat e duhura të sigurisë në lidhje me rreziqet e dëmtimeve trupore ose dëmtime të tjera ndaj palëve të treta, që kanë lidhje me ekzekutimin e punimeve.

8. Koncesionari garanton që të gjitha punimet dhe shërbimet, me qëllim shfrytëzimin e sipërfaqes së dhënë me koncesion nëpërmjet kësaj Marrëveshjeje koncesioni, në përputhje me planin e projektit dhe vënien e tij në shfrytëzim, do të kryhen në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

9. OSHA do të përjashtohet nga çdo përgjegjësi për dëmtime trupore ose dëme të tjera që mund t'i ndodhin koncesionarit ose të punësuarve të tij, aksidentalisht ose jo, gjatë kryerjes së

punimeve dhe veprime të tjera në projekt.

Neni 6

Të drejtat dhe detyrat e OSHA-së

1. OSHA ka të gjitha të drejtat e mbikëqyrjes së koncesionit, sipas kushteve të përcaktuara në këtë Marrëveshje.

2. OSHA do të jetë e ngarkuar me çështjet që kanë lidhje me projektin dhe zbatimin e tij, në përputhje me termat dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje, për sa kohë që këto çështje i përkasin shtetit shqiptar dhe autoriteteve publike, bazuar në ligjin për koncesionet dhe ligjeve të tjera në fuqi.

3. Në mënyrë të veçantë, OSHA merr përsipër detyrimet e mëposhtme:

a) Të vërë në dispozicion të koncesionarit sipërfaqen për shfrytëzim, me qëllim zbatimin e projektit, pa detyrime ose pengesa, në përputhje me, dhe në varësi të kushteve të nenit 10 të kësaj Marrëveshjeje, dhe në çdo rast të lehtësojë të gjitha problemet, si dhe të gjitha veprimet e koncesionarit, të nevojshme për këtë qëllim;

b) Të ndihmojë për të siguruar akses për koncesionarin, ose lidhje me impiante të tjera të shërbimeve publike, të nevojshme për veprimtarinë në vendndodhjen e projektit, për ndërtimin dhe operimin e fabrikës;

c) Të asistojë që koncesionari do të jetë në gjendje të organizojë dhe të kryejë, në kushte normale të gjitha inspektimet dhe kërkime të tjera për qëllime të projektimit të detajuar dhe shfrytëzimit të sipërfaqes së tokës, si edhe të kryejë vlerësime apo studime, që do të kërkoreshin ose do të ishin të përshtatshme në lidhje me projektin, bazuar në ligjet në fuqi;

d) Të garantojë që koncesionarit do t'i jepen, brenda afateve kohore të paracaktuara mes palëve, dhe/ose parashikuar nga ligjet në fuqi, të gjitha lejet e zbatueshme, për kryerjen e punimeve ose zbatimeve të tjera të projektit nga koncesionari, duke përfshirë, por pa u kufizuar në:

i) leje sheshi ndërtimi (sipas rregullave të planifikimit) dhe leje ndërtimi (sipas rregullave të ndërtimit);

e) Të ndihmojë koncesionarin, me gjithë mbështetjen e arsyeshme, në marrëdhëniet e nevojshme ose marrëveshjet me autoritete të tjera ose institucione publike në Shqipëri, në ndjekje të projektit dhe detyrimeve të tij në këtë Marrëveshje, siç janë shqyrtimi i kërkesave, miratimet, si dhe sigurimi i marrëveshjeve ose kontratave.

4. Në përputhje me sa më sipër, OSHA merr gjithashtu përsipër:

a) Të garantojë gëzimin e qetë të sipërfaqes së dhënë në koncesion dhe pa ndërhyrje nga palë të treta që mund të ngrejë pretendime pronësie, për të gjithë periudhën e kohëzgjatjes së Marrëveshjes.

b) Të asistojë kryerjen e detyrimeve të saj në këtë Marrëveshje, dhe angazhohet t'i ofrojë koncesionarit çdo lloj ndihme të nevojshme shtesë që mund t'i japë shtysë shfrytëzimit të saj në autonomi të plotë, sipas ligjeve shqiptare në fuqi.

Neni 7

Investimi i vlerësuar

1. Në bazë të informacionit në dispozicion të koncesionarit dhe përvojës së përgjithshme të tij në projekte, investimi në sipërfaqen e dhënë me koncesion për fabrikën “me çelësa në dorë”, të gatshëm për veprimtari tregtare vlerësohet të jetë 100 milionë euro.

2. Ky vlerësim pasqyron fazën e zhvillimit të projektit, përshkruar në shtojcën A të kësaj Marrëveshjeje. Karakteristikat fizike të projektit të fabrikës mund të rishikohen në një fazë të mëvonshme dhe vlera e investimit në sipërfaqen e dhënë me koncesion mund të ndikohet nga faktorë ekonomikë, përfshirë luhatjet në çmimet e tregut dhe normat e këmbimit të valutës. Ndryshimet në projektim apo ndërtim, me qëllim optimizimin ose rritjen e kapacitetit të fabrikës dhe cilësisë së tij operuese do të kryhen gjithmonë me shpenzime të koncesionarit.

3. Në bazë të ligjit, koncesionari ka të drejtë të nënshkruajë kontrata dhe nënkontrata me palë të treta të pavarura, për shfrytëzimin e plotë ose të pjesshëm të sipërfaqes në të cilën do të ndërtohet plotësisht ose pjesërisht fabrika. Megjithatë, në të njëjtën kohë, koncesionari do të jetë e vetmja palë përgjegjëse përpara OSHA-së dhe ndaj çdo pale të tretë për zbatimin e projektit përfundimtar dhe për

çdo detyrim që ka të bëjë me shfrytëzimin.

4. Palët bien dakord se për çështjet ku kërkohet një leje e posaçme për shfrytëzimin, përveç atyre të parashikuara në nenin 6 (Të drejtat dhe detyrat e OSHA-së), koncesionari do të paraqesë një kërkesë tek OSHA dhe OSHA do të ndihmojë koncesionarin për marrjen e lejes së zbatueshme përkatëse brenda kohës së parashikuar nga ligji përkatës shqiptar.

Neni 8

Periudha e koncesionit

1. Koncesioni i dhënë koncesionarit në bazë të kësaj Marrëveshjeje do të bëhet i vlefshëm me hyrjen në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe do të zgjasë për një periudhë 30 (tridhjetë) vjet.

2. Me përfundimin e periudhës së koncesionit të parashikuar në paragrafin e mësipërm (1), kjo Marrëveshje koncesioni mund të rinovohet për një periudhë të mëtejshme, me kusht që të bëhet një kërkesë me shkrim për këtë rinovim nga koncesionari, dy vjet përpara përfundimit të periudhës së parë. Afatet dhe kushtet e parashikuara në këtë Marrëveshje do të zbatohen edhe për periudhën e rinovuar të koncesionit.

3. Koncesionari, si dhe pasardhësit e tij të ligjshëm apo një palë e tretë, do të kenë të drejtën të gëzojnë dhe/ose t'u jepen të drejta, siç mund të jetë e nevojshme në atë kohë, bazuar në ligjet shqiptare, për vazhdimin e shfrytëzimit të fabrikës.

Neni 9

Vënia në dispozicion e terrenit

1. Menjëherë sapo të ketë hyrë në fuqi kjo Marrëveshje, koncesionari do të informojë me shkrim OSHA-në në lidhje me sipërfaqen e tokës që duhet të merret në dorëzim për qëllime të projektit, si dhe të tregojë kohën kur duhet kryer kjo.

2. Trualli dhe të drejtat reale mbi të që i përkasin shtetit do të jepen në përdorim të koncesionarit, pa pagesë, në bazë të ligjeve në fuqi, që nga koha e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje deri në përfundimin e periudhës së parë të koncesionit dhe/ose periudhës së rinovuar të koncesionit.

3. Koncesionari do të ketë të drejtën të blejë tokën në pronësi të shtetit dhe të drejtat reale mbi të në tërësi ose pjesërisht në çdo moment pas përfundimit të Marrëveshjes së koncesionit ose periudhës së rinovuar të koncesionit. Çmimi për fitimin e pronësisë së truallit dhe të drejtave reale mbi pronën do të përcaktohet sipas ligjeve shqiptare në fuqi në momentin që do të ushtrohet e drejta për blerje.

Neni 10

Regjistrimi i të drejtave të pronësisë

Transferimi i pronësisë së truallit ose interesave të pronës të blera nga shteti shqiptar në përputhje me nenin 9 (2) më sipër do të përfundohet përmes regjistrimit të kësaj prone në emër të koncesionarit në të njëjtën kohë me pagimin e çmimit të plotë që do të paguhet për pronën.

Neni 11

Transferimi i koncesionit

Koncesionari nuk mund të transferojë ose ta kalojë këtë Marrëveshje koncesioni ose ndonjë pjesë të së drejtës së koncesionit të dhënë në këtë Marrëveshje, te ndonjë palë tjetër pa miratimin me shkrim të OSHA-së. Në rast se koncesionari nuk ka marrë miratimin, kjo Marrëveshje mund të shpallet e zgjidhur nga OSHA dhe mund të përfundohet, në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 13 më poshtë përsa i takon përgjegjësisë dhe detyrimeve të palëve.

Neni 12

Mospërbushja dhe përfundimi

1. Në rast se një nga palët nuk përmbush detyrimet e saj sipas kësaj Marrëveshjeje, pala e cila është në mospërmbushje do të përgjigjet brenda 60 ditëve nga dita që është njoftuar nga pala tjetër në lidhje me mospërmbushjen dhe do të marrë të gjitha masat e nevojshme për të ndrequr dhe/ose eliminuar këtë mospërmbushje brenda 90 (nëntëdhjetë) ditëve nga dita që ka marrë njoftimin, si dhe për të zbutur pasojat e dëmshme të shkaktuara palës tjetër.

2. Një mospërmbushje nga cilado palë e ndonjë prej detyrimeve të saj nuk do të dëmtojë automatikisht përmbushjen e detyrimeve të tjera të parashikuara në Marrëveshje, dhe nuk do të bëjë të lindë e drejta për pezullim apo përfundim të detyrimeve nga pala tjetër, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe më poshtë. Pala, e cila nuk është në gjendje mospërmbushje, do të kërkojë me mirëbesim që të zbuten efektet e mospërmbushjes ndaj saj, me aq sa është e mundur sipas mendimit të saj.

3. Secila palë do të ketë gjatë të gjithë kohës të drejtën të pezullojë kryerjen e detyrimeve për shkak të një mospërmbushjeje nga ana e palës tjetër në atë masë që një pezullim i tillë është i arsyeshëm sipas mendimit të saj, për të shmangur humbje ose dëme thelbësore ndaj interesave e pronave të saj dhe/ose detyrime thelbësore ndaj palëve të tjera, si rezultat i rrethanave të shkaktuara nga mospërmbushja.

4. Në rast të një dëmi thelbësor material nga cilado palë gjatë përmbushjes së detyrimeve, pala tjetër do të ketë të drejtën e kompensimit për dëmin ose humbjen e verifikuar, që rezulton nga ky mosplotësim, bazuar në Kodin Civil Shqiptar.

Neni 13

Kontratat

1. Koncesionari do të ketë të drejtën të lidhë kontrata me palë të kualifikuara për kryerjen e sipërmarrjeve të veçanta, që përbëjnë një pjesë të detyrave të tij në lidhje me shfrytëzimin e sipërfaqes dhe zbatimin e elementeve të tjera të projektit, bazuar në procedura të duhura prokurimi të vendosura nga koncesionari. Këto kontrata duhet të sigurojnë se palët pjesëmarrëse në to do të veprojnë në përputhje me kushtet e kësaj Marrëveshjeje.

2. OSHA nuk do të marrë përsipër asnjë detyrim përpara palëve të treta, punëtorëve apo shoqërive të angazhuara përmes kontratave të tilla.

Neni 14

Mirëmbajtja dhe operimi

1. Koncesionari do të sigurojë, me shpenzimet e tij, të gjithë mirëmbajtjen e nevojshme, në mënyrë që të mbajë në punë fabrikën gjatë të gjithë periudhës së koncesionit, përmes shërbimeve parandaluese, si edhe riparuese.

2. Koncesionari do të sigurojë të gjithë administrimin e shfrytëzimit të fabrikës përgjatë periudhës së koncesionit, si nga ana teknike, ashtu edhe financiare apo aspekte të tjera.

Neni 15

Kontrolli dhe inspektimi i shfrytëzimit të sipërfaqes

1. Sapo projekti përfundimtar dhe plani i projektit për fabrikën të jenë përfunduar nga koncesionari, ai do t'i dorëzohet OSHA-së, e cila brenda 30 ditëve do t'i dërgojë koncesionarit komentet e mundshme.

2. Koncesionari do t'i paraqesë OSHA-së raporte tremujore mbi ndërtimin e fabrikës. OSHA, sipas mundësive dhe në çdo kohë, do të kryejë inspekte në lidhje me shfrytëzimin dhe do të furnizohet me informacione teknike që kanë të bëjnë me ecurinë dhe cilësinë e punimeve.

3. OSHA-së, në marrëveshje me koncesionarin, do t'i ofrohet ndihma e nevojshme herë pas here, dhe nuk do të ketë vështirësi për përfaqësuesin e saj të autorizuar që të hyjë në vendndodhjen e projektit dhe përmbushë detyrën e tij të mbikëqyrjes për të verifikuar që afatet dhe kushtet e kësaj Marrëveshjeje po zbatohen.

4. Përfundimi i fabrikës, në përputhje me këtë Marrëveshje koncesioni për shfrytëzimin e sipërfaqes, do të konfirmohet përmes një protokollit të nënshkruar ndërmjet OSHA-së dhe koncesionarit dhe shoqërohet nga një raport të përgatitur nga koncesionari dhe të miratuar nga OSHA,

ku të përmblihdhet përfundimi i punimeve dhe fillimi i shfrytëzimit të fabrikës.

Neni 16

Mbikëqyrja e përgjithshme

1. OSHA do të ketë të drejtën dhe detyrimin të ushtrojë mbikëqyrje mbi aktivitetet e koncesionarit, në lidhje me shfrytëzimin e duhur të sipërfaqes që nga koha e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje dhe pas kësaj, përgjatë kohëzgjatjes së periudhës së koncesionit.

2. Përgjatë periudhës së koncesionit, koncesionari do t'i ofrojë OSHA-së raporte sistematike mbi shfrytëzimin dhe mirëmbajtjen e sipërfaqes. Veç kësaj, përfaqësuesit e saj të autorizuar kanë lejen që të vizitojnë sipërfaqen kohë pas kohe, me të drejtë të pakufizuar hyrje në vendndodhjen e projektit, sipas marrëveshjeve të mëtejshme ndërmjet palëve ose me kërkesë të veçantë, për të kryer çdo lloj inspektimi të nevojshëm për të verifikuar që detyrimet e kësaj Marrëveshjeje koncesioni po përmbushen dhe zbatohen në mënyrën e duhur nga koncesionari.

3. Në rast se dalin probleme gjatë kryerjes së supervizimeve nga ana e OSHA-së, koncesionari do të informohet menjëherë me shkrim për çdo ankesë të rëndësishme dhe do t'u kushtojë çështjeve në fjalë vëmendje përmes një përgjigjeje me shkrim ose ndonjë mënyrë tjetër.

Neni 17

Ligji i zbatueshëm

1. Zbatimi dhe interpretimi i kësaj Marrëveshjeje koncesioni do të bëhet mbi bazën e ligjeve shqiptare, që janë në fuqi në kohën e nënshkrimit të Marrëveshjes.

2. OSHA garanton se çdo ligj i nxjerrë më vonë nuk mund të cenojë detyrimet e pranuar nga palët në këtë Marrëveshje ose të ndryshojë kushtet e saj.

Neni 18

Forca madhore

1. Konsiderohen ngjarje të forcës madhore të tilla, si: katastrofat natyrore, përmytjet, tërmetet, gjendja e luftës dhe çdo ngjarje e barabartë që mund të ndikojë në objektin e kësaj Marrëveshjeje, duke bërë të pamundur përmbushjen e detyrimeve reciproke të Marrëveshjes.

2. Gjatë zbatimit të Marrëveshjes, në rast se verifikohen ngjarje të forcës madhore, vonesa të mundshme ose mosrespektim të detyrimeve të palëve, ato nuk mund të jenë motiv për kërkesa reciproke për zhvendim.

3. Në rast të kundërt, kur një detyrim i kësaj Marrëveshjeje do të prishet ose do të hiqet si rezultat i forcës madhore, pala e dëmtuar është e detyruar të njoftojë me shkrim palën tjetër, duke i treguar dhe duke arsyetuar shtyrjen e punimeve ose braktisjen e tyre, si dhe masat që do të merren për të parandaluar pasojat.

4. OSHA ka të drejtën të kryejë të gjitha verifikimet e nevojshme lidhur me sa më sipër, si dhe koncesionari është i detyruar ta asistojë atë në veprimet e mësipërme.

5. Kufijtë e ndërprerjes së punimeve dhe të shtyrjes në kohë të punimeve do të konfirmohen nga palët në një procesverbal të ngjarjes rast pas rasti.

6. Për dëme dhe vonesa të shkaktuara për faj të të tretëve, të cilat nuk konsiderohen forcë madhore dhe të cilat nuk varen nga koncesionari, por që pengojnë realizimin në afat të Marrëveshjes, palët mund të rishikojnë me mirëkuptim afatet e Marrëveshjes.

7. Pezullimi i punimeve ose mosshfrytëzimi i objektit të kësaj Marrëveshjeje, për shkak të forcës madhore shtyn periudhën e koncesionit për aq kohë sa ka vazhduar forca madhore dhe eliminimin e pasojave të saj.

Neni 19

Ndryshimet e kushteve të Marrëveshjes së koncesionit

1. Kjo kontratë e shkruar dhe anekset bashkëngjitur, përbëjnë marrëveshjen e plotë midis palëve. Diskutimet gojore dhe parashtrimet e bëra gjatë negocimit për lidhjen e saj nuk përbëjnë kushte të kësaj Marrëveshjeje.

2. Çdo ndryshim apo modifikim i kushteve të kësaj Marrëveshjeje do të jetë i vlefshëm vetëm pasi të jetë bërë me shkrim dhe të jetë nënshkruar nga të dyja palët.

Neni 20

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

1. Çdo mosmarrëveshje që mund të lindë ndërmjet palëve nga ose në lidhje me Marrëveshjen e koncesionit apo zbatimin e projektit, nuk do të bjerë ndesh dhe pengojë detyrimet për të përmbushur në tërësi këtë Marrëveshje koncesioni.

2. Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin ndërmjet palëve në lidhje me këtë Marrëveshje koncesioni do të zgjidhen në mirëkuptim midis tyre, në të kundërt kompetente për zgjidhjen e mosmarrëveshjes do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë.

Neni 21

Ruajtja e vlerave kulturore dhe arkeologjike

1. Koncesionari do të informojë menjëherë OSHA-në për çdo zbulim të objekteve me vlerë kulturore dhe arkeologjike, të zbuluar gjatë shfrytëzimit të sipërfaqes. Çdo zbulim i këtij lloji do të dorëzohet në përputhje me ligjin.

Neni 22

Hyrja në fuqi e Marrëveshjes së koncesionit

1. Kjo Marrëveshje koncesioni do të hyjë në fuqi pas miratimit nga ana e Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, në përputhje me nenin 9 (3) të ligjit për koncesionet.

Neni 23

Dispozita të përgjithshme

1. OSHA dhe koncesionari do të bëjnë të ditur emrin e personit përgjegjës për administrimin e kësaj Marrëveshjeje koncesioni.

2. Marrëveshja e koncesionit është hartuar në anglisht dhe të gjitha dokumentet dhe detajet do të jenë në anglisht.

3. Marrëveshja e koncesionit është hartuar dhe firmosur në tre origjinale nga të cilët dy i mban OSHA dhe një koncesionari.

4. Nëse nuk ka ndonjë dispozitë tjetër nga palët, i gjithë letërkëmbimi mes palëve do të dërgohet në:

OSHA

Koncesionari

VENDIM

Nr.522, datë 8.7.2005

PËR TRANSFERIMIN E FONDEVE FINANCIARE TË KREDITORËVE TË SHOQËRIVE HUAMARRËSE NË ADMINISTRIM NGA LLOGARITË BANKARE TË RAIFFEISEN BANK SHA, TE BANKA KOMBËTARE TREGTARE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Koordinimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Fondet financiare të shoqërive huamarrëse në administrim, gjendje pranë Raiffeisen Bank sh.a., të caktuara me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave për shpërndarje kreditorëve, sipas

koeficientit të kthimit të shumave pas rakordimeve dhe marrjes në dorëzim të dokumentacionit nga administratorët e pavarur, të transferohen pranë Bankës Kombëtare Tregtare, në llogari të veçanta bankare, në dobi të kreditorëve të secilës shoqëri huamarrëse.

2. Raiffeisen Bank sh.a., në madhësinë e vlerës financiare për transferim, krahas të ardhurave të caktuara për çdo kreditor, me vendime të veçanta të Këshillit të Ministrave, sipas koeficientëve të kthimit të shumave, të llogarisë për çdo shoqëri huamarrëse në administrim, interesat bankarë në përfitim nga koha e depozitimit të vlerave financiare për shpërndarje deri në transferimin e tyre, në përputhje me kushtet e punës, të pranuar nga banka për të gjithë klientët sipas përcaktimit të pikës 2 të nenit 8 të ligjit nr.8360, datë 10.6.1998 “Për kriteret dhe mënyrën e shpërndarjes së pasurive të personave juridikë, jobankarë, që kanë marrë hua nga publiku i gjerë”.

3. Ngarkohen administratorët e pavarur të shoqërive huamarrëse që, në përfundim të rakordimit të numrit të kreditorëve, për vlerat financiare të shpërndara dhe ato të mbetura gjendje për transferim te Banka Kombëtare Tregtare të tërheqin dhe të administrojnë të gjithë dokumentacionin e pagesave të kryera kreditorëve nga ish-Banka e Kursimeve dhe Raiffeisen Bank sh.a., përfshi kontratat e huamarrjes, mandatpagesat dhe dokumentacionin tjetër shoqërues, të përdorur për shlyerjen e tyre.

4. Kudo në vendimet nr.47, datë 3.2.1997, nr.610, datë 21.12.1999, nr.162, datë 13.4.2000, nr.163, datë 13.4.2000, nr.361, datë 14.7.2000, nr.116, datë 31.2.2002 dhe nr.491, datë 23.7.2004 të Këshillit të Ministrave, emërtimet “...Banka e Kursimeve dhe Raiffeisen Bank sh.a...” zëvendësohen me “...Banka Kombëtare Tregtare...”.

5. Ngarkohet Banka Kombëtare Tregtare, me degët e saj në rrethe që, në përputhje me marrëveshjen, që do të lidhet në zbatim të këtij vendimi ndërmjet Grupit Mbikëqyrës dhe kësaj banke, të bëjë shpërndarjen e vlerave financiare kreditorëve të mbetur të fondacionit “Populli” dhe “Xhaferri”, të shoqërive huamarrëse “M. Leka” sh.p.k., “Universi” sh.p.k., “Global Foods” sh.p.k., “Silva” sh.p.k., “Cenaj & Co” sh.p.k. dhe “Kamberi Co” sh.p.k., në administrim.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

VENDIM

Nr.524, datë 8.7.2005

PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME DHE TË KULTURAVE TË NDRYSHME BUJQËSORE, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA LIDHJA ME SISTEMIN E NËNSTACIONIT 220/110 KV, RRASHBULL

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21 të ligjit nr.8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Industrisë dhe të Energjetikës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme dhe të kulturave të ndryshme bujqësore, pronë private, që preken nga lidhja me sistemin e nënstacionit 220/110 kV, Rrashbull, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të KESH sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, dhe pronarët e kulturave bujqësore të dëmtuara, të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, të përcaktuar në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqën 606 (gjashtëqind e gjashtë) m² tokë bujqësore arë dhe kultura të ndryshme bujqësore, në shumën e përgjithshme prej 1 087 720 (një milion e tetëdhjetë e shtatë mijë e shtatëqind e njëzet) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondet e KESH sh.a., zëri “Kosto lokale për shpronësimet”.

5. Vlera e shpenzimeve procedurale të shpronësimit, në shumën prej 193 000 (njëqind e nëntëdhjetë e tre mijë) lekësh, të jetë në ngarkim të KESH sh.a., kërkuar për shpronësim.

6. Procedura e shpronësimit të fillojë brenda muajit korrik 2005 dhe të përfundojë brenda tremujorit të tretë të po këtij viti.

7. Punimet për realizimin e këtij projekti kanë përfunduar.
 8. Ngarkohen Ministria e Industrisë dhe e Energjetikës dhe KESH sh.a., për zbatimin e këtij vendimi.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E INDUSTRIE DHE ENERGJETIKËS**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË "LIDHJES SE NENSTACIONIT 220/110 KV RRASHBULL ME SISTEMIN".

**RRETHI DURRËS
KOMUNA RRASHBULL**

Lloji i pasurisë që shpronësohet: Tokë bujqësore Arë.

Nr.	EMRI	MBIEMRI	Nr. pasurisë	Sip. Tokës në m ²	Çmimi lekë/m ²	Vlera e kompesimit në lekë	Shenime
1.	ZAIM	HOXHA	25/33	16	1 100	17 600	Nese paraqet Dokumentin e Pronesise
2.	AVDI	GASHI	56/1	16	1 100	17 600	
3.	ASLLAN	KOSTURI	55/1	100	1 100	110 000	
4.	FRANÇESK	VUKAJ	56/22	97	1 100	106 700	
5.	HAJREDIN	NIKOÇI	56/24	98	1 100	107 800	
6.	HAKI	NIKOÇI	56/18	49	1 100	53 900	
7.	GRAMOZ	BESHTIKA	71/41 (71/12)	100	1 100	110 000	
8.	ISUF	VELA	56/45 (56/23)	81	1 100	89 100	
9.	ENKELEDA DHE ENTELA	SHQUTI	78/20	49	1 100	53 900	
/	Totali		----	606	---	666.600	-----

LISTA EMERORE E PERSONAVE QE DO TE ZHDEMTOHEN PER KULTURAT E NDRYSHME BUJQESORE TE DEMTUARA GJATE PUNIMEVE PER LIDHJEN E NENSTACIONIT 220/110 KV RASHBULL ME SISTEMIN.

Nr.	EMRI MBIEMRI	Sip. Totale ne m ² per kulturat bujqesore te demtuara				Vlera ne leke e kompesimit per secilen prej kulturave bujqesore te demtuara				Vlera totale e kompesimit ne lekë	
		Lojum	Jonxhe	Tershere	Kumbull	Hardhi	Lojum	Jonxhe	Tershere	Kumbull	Hardhi
1.	Zaim Hoxha	175	-	-	-	-	3500	-	-	-	3.500
2.	Zydi Gashi	-	1300	-	-	-	-	52.000	-	-	52.000
3.	Hajredin Nikoçi	885	1600	-	-	-	17.700	48.000	-	-	65.700
4.	Musa Fetahi	1012	-	-	-	-	20.240	-	-	-	20.240
5.	Isuf Velo	1200	1200	800	10 cope	50 cope	24.000	72.500	8000	5.000	100.000
6.	Bajram Buçeza	2384	-	-	-	-	47.680	-	-	-	47.680
7.	Haki Nikoçi	1125	-	-	-	-	22.500	-	-	-	22.500
/	Totali										421.120

• Sqarime: Shpenzime procedurale: 1. Publikime 168.000 (njëqindgjashtëdhjetëtetëmijë) lekë

2. Shpërblim i anetares te komisionit 25.000 (njetëzetëpesëmijë) lekë.

Vlefte totale e shpronësimit = 1.087.720 + 193.000 = 1.280.720 (njëmilion e dyqindetëdhjetëetëmijë e shtatëqindnjëzetë) lekë.

VENDIM
Nr.525, datë 8.7.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.96, DATË 24.2.1997 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR PAGESËN E TË PUNËSUARVE TË PORTIT DETAR Durrës, TË
CILËT DALIN TË PAPUNË SI PASOJË E ZBATIMIT TË PROJEKTIT TË
RISTRUKTURIMIT TË KËTIJ PORTI”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të ligjit nr.8306, datë 14.3.1998 “Për strategjinë e privatizimit të sektorëve me rëndësi të veçantë”, me propozimin e Ministrit të Transportit dhe të Telekomunikacionit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.96, datë 24.2.1997 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Të punësuarit në Autoritetin Portual Durrës, të cilët dalin të papunë si pasojë e ristrukturimit dhe proceseve të privatizimit të sektorëve të ndryshëm të këtij porti, përfitojnë të drejtën e pagesës për një periudhë njëvjeçare, në masën 100 për qind të pagesës mesatare mujore, të vitit të fundit të punës, por jo më pak se paga minimale, në shkallë vendi, në çastin e shkëputjes nga puna.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Përfitojnë nga ky vendim të punësuarit në Autoritetin Portual Durrës, të cilët kanë qenë të punësuar në këtë Autoritet pa ndërprerje, për një periudhë kohe jo më pak se 1 (një) vit dhe vazhdojnë të jenë të punësuar në këtë Autoritet nga data 15.4.2005 deri më 21.10.2006.”.

c) Në pikën 4, emërtimi “Autoriteti Portual Durrës sh.a.” zëvendësohet me “Autoriteti Portual Durrës”.

ç) Në pikën 7, fjalët “...Ministria e Ekonomisë Publike dhe e Privatizimit dhe Ministria e Transportit...”, zëvendësohen me “...Ministria e Transportit dhe e Telekomunikacionit...”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

VENDIM
Nr.532, datë 9.6.2005

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.440, DATË 9.9.1999 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR STRUKTURËN DHE PAGAT E PUNONJËSVE TË POLICISË SË
NDËRTIMIT”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 11 të ligjit nr.8408, datë 25.9.1998 “Për Policinë e Ndërtimit”, me propozimin e Ministrit të Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.440, datë 9.9.1999 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të bëhen këto ndryshime:

a) Pika 1 ndryshohet si më poshtë vijon:

“1. Policia e Ndërtimit funksionon në varësi të Ministrisë së Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit. Struktura e saj përbëhet nga drejtoria, me qendër në Tiranë, dhe 14 degë, të organizuara në

rrethe, nga të cilat 6 degë të kategorisë së parë dhe 8 degë të kategorisë së dytë, sipas lidhjeve nr.1 e nr.2, që i bashkëlidhen këtij vendimi.”.

b) Pika 2 ndryshohet si më poshtë vijon:

“2. Numri i përgjithshëm i punonjësve të Policisë së Ndërtimit është 185 veta.”.

2. Efektet financiare, që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi, të përballohen nga buxheti i vitit 2005, zëri “Paga dhe sigurime shoqërore”, miratuar për Ministrinë e Rregullimit të Territorit dhe të Turizmit.


3. Ngarkohet Ministria e Rregullimit të Territorit dhe e Turizmit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI

Fatos Nano

STRUKTURA E POLICISES NE DERTIM TË NEJENDE RDHENE RRETHE



STRUKTURA ORGANIKE E POLICISE SE NDERTIMIT NE QENDER DHE NE RRETHE

Nr	Emërtimi	Drejtor	Zv/Drejtor	Kryetar Dege	Shef Sektori	Revizor	Specialist Finance	Specialist Teknik	Specialist te m. me publik	Specialist Jurist	Specialist per armatim	Komandant Gr Special	Specialist Gr Special	Sekretare - Daktilografi	Dezhurn	Shofer	Arshiv - Protokoll	Magaznier	Pastruese	Shuma
1	Drejtoria	1	1	4		1	1	7	3	3	1		1	8	1	5	1	1	1	41
2	Dega TR-Qytet K1			1	3		1	14		2		1	6			4	1	1	1	35
2	Dega TR-Rreth K2			1			1	4		1						1				8
4	Dega Vlore K1			1	1		1	4		1		1	4			1				14
5	Dega Lezhe K1			1			1	4		1		1	2			1				11
6	Dega Elbasan K2			1			1	3		1						1				7
7	Dega Korçe K2			1	1		1	4		1						1				9
8	Dega Shkoder K2			1			1	4		1		1	2			1				11
9	Dega Kukes K2			1			1	2								1				5
10	Dega Diber K2			1			1	2								1				5
11	Dega Berat K2			1			1	2								1				5
12	Dega Gjirok. K2			1			1	2								1				5
13	Dega Fier K2			1			1	3		1						1				7
14	Dega Durres K1			1			1	5		1		1	5			1				15
15	Dega Sarande K2			1			1	3		1						1				7
	Shuma	1	1	18	5	1	15	63	3	14	1	6	27	1	1	22	2	2	2	185

UDHËZIM
Nr.12, datë 30.3.2005

PËR DISA NDRYSHIME DHE PLOTËSIME NË UDHËZIMIN “PËR TARIFAT E LEJIMIT, REGJISTRIMIT DHE PAGESAT E VERIFIKIMIT DHE KALIBRIMIT TË MJETEVE MATËSE DHE RREGULLAT E ZBATIMIT TË TYRE”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe në zbatim të nenit 15 të ligjit nr.8996, datë 30.1.2003 “Për njësitë e matjes dhe kontrollin e mjeteve matëse (metrologjinë)”, me propozimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë dhe Kalibrimit, Ministria e Financave

UDHËZON:

Në udhëzimin “Për tarifën e lejimit, regjistrimit dhe pagesat e verifikimit dhe kalibrimit të mjeteve matëse dhe rregullat e zbatimit të tyre”(komunikuar kësaj drejtorie me shkresën nr.2135, datë 8.5.2003 për shkak se ky udhëzim në botim ka dalë pa numër dhe datë, vetëm me emërtim) të bëhen ndryshimet dhe plotësimet si më poshtë:

1. Pika 7, nënpika a, germa “i” dhe “ii” ndryshohen si më poshtë:

Për peshoret hekurudhore, automobilistike dhe ato me platformë për transportin e bazës etalonuese:

- Për largësi të vendndodhjes së peshores, që verifikohet deri në 45 km nga DPMK, shpenzimet shtesë merren në vlerën fikse 5000 lekë.

- Për largësi të vendndodhjes së peshores mbi 45 km, shpenzimet shtesë përcaktohen nga produkti i largësisë në km së vendndodhjes së saj nga DPMK, me tarifën 110 lekë/km.

2. Pika 17 ndryshohet si vijon:

Për kryerjen e aktiviteteve verifikuese dhe kalibruuese të pakryera me parë lejohet të punohet me tarifa provizore të përcaktuara nga DPMK-ja ; DPMK brenda 6 muajve nga aplikimi i tarifës kërkon miratimin e saj në Ministrinë e Financave.

3. Germa “b” e pikës 2 në pasqyrën nr.1, fjalja “ Për çdo grup prej 5 mjeteve matëse paguhet 10% e çmimit të blerjes së një mjeti” ndryshohet si vijon:

- Për mostra mjeteve matëse 10 000 lekë

4. Pika 6.6 në pasqyrën 3 ndryshohet:

Gjatë procesit të kalibrimit të enëve volumore, autoboteve, autocisternave dhe rezervuarëve paguhet tarifa e mëposhtme sipas volumeve:

- Kapaciteti 2000 m³, tarifa bazë 600 000 lekë

- Për çdo ulje kapaciteti me 500 m³ nga 2000 m³,
do të bëhet një ulje e tarifës bazë me 20 000 lekë

- Për çdo shtesë me 1000 m³ mbi kapacitetin
2000 m³, do të bëhet një rritje e tarifës
bazë me 40 000 lekë

- Për kapacitete nën 500 m³ do të bëhet pagesa
për çdo nënndarje 10 cm në vlerën 6500 lekë.

- Kur një subjekt në të njëjtën kohë kërkon që të kalibrojë disa rezervuarë, autocisterna, autobotë apo enë volumore që ndodhen në të njëjtin vend, tarifa për mjetin e parë do të merret e plotë, ndërsa për të tjerët do të merret 0.8 e tarifës përkatëse.

5. Në pikën 10.2 bëhen këto ndryshime:

Kufiri - mbi 1 kg deri 10 kg bëhet: mbi 1 kg deri 15 kg

Kufiri - mbi 10 kg deri 100 kg bëhet: mbi 15 kg deri 100 kg

6. Në pikën 10.3 bëhen këto ndryshime:

Kufiri - mbi 1 kg deri 10 kg bëhet: mbi 1 kg deri 15 kg
Kufiri-mbi 10 kg deri 50 kg bëhet: mbi 15 kg deri 50 kg

7. Në pasqyrën nr.3 shtohen pikat:

1.6 Komperator	3000 lekë
1.7 Kalibër	3000 lekë
1.8 Mikrometër	3000 lekë
19.3 Termometra me zhivë	2000 lekë

8. Nga pasqyra nr.3 hiqet pika nr.10.6.

9. Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I FINANCAVE
Arben Malaj

VENDIM
Nr.1, datë 1.7.2005

PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI INSTITUT
PRIVAT PENSIONESH SUPLEMENTARE

Mbështetur në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensione", (të ndryshuar), si dhe në vendimin nr.908, datë 29.12.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes", Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, pasi:

a) ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur duke analizuar të gjithë informacionin e siguruar prej tij;

b) ka diskutuar me bordin drejtues të institutit për objektivat e këtij instituti në treg, planbiznesin e paraqitur, kapitalizimin e propozuar të institutit, organizimin e tij, projektet financiare të institutit për tri vitet e ardhshme, politikat kryesore të investimeve të propozuara etj.;

c) ka vlerësuar, në bazë të planbiznesit të paraqitur, të rehat që do të sjellë instituti në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së tij në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg;

d) ka vlerësuar planbiznesin e paraqitur dhe konstaton se ai është real dhe bindës;

e) ka vlerësuar mundësinë e aksionarëve të propozuar të institutit për të shtuar kapitalin, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet, që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë si institut pensionesh;

f) ka shqyrtuar transparencën e burimeve dhe të strukturës së kapitalit aksionar të institutit; g) ka vlerësuar strukturën organizative dhe ambientet e shërbimit të institutit të propozuar;

h) është siguruar se pjesëtarët e bordit drejtues dhe të stafit ekzekutiv të institutit privat të pensioneve suplementare të propozuara, janë të aftë profesionalisht;

i) ka vlerësuar dhe ka verifikuar opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e paraqitur për zhvillimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare të llojit i hapur për subjektin "GARANTSIG IPP SHA".

2. Subjekti "GARANTSIG IPP SHA" pas dhënies së lejes, si dhe pas regjistrimit në regjistrin tregtar si shoqëri anonime, detyrohet të fillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare brenda datës 30.9.2005.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Naim Hasa

VENDIM
Nr.2, datë 1.7.2005

PËR DHËNIEN E LEJES PËR USHTRIMIN E VEPRIMTARISË SI INSTITUT

PRIVAT PENSIONESH SUPLEMENTARE

Mbështetur në ligjin nr.7943, datë 1.6.1995 "Për pensionet suplementare dhe institutet private të pensione", (të ndryshuar)", si dhe në vendimin nr.908, datë 29.12.2004 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Inspektoratit të Instituteve Private të Pensioneve Suplementare dhe për procedurat e licencimit dhe të mbikëqyrjes"", Inspektorati i Instituteve Private të Pensioneve Suplementare, pasi:

- a) ka vlerësuar të gjithë dokumentacionin e paraqitur duke analizuar të gjithë informacionin e siguruar prej tij;
- b) ka diskutuar me bordin drejtues të institutit për objektivat e këtij instituti në treg, planbiznesin e paraqitur, kapitalizimin e propozuar të institutit, organizimin e tij, projektet financiare të institutit për tri vitet e ardhshme, politikat kryesore të investimeve të propozuara etj.;
- c) ka vlerësuar, në bazë të planbiznesit të paraqitur, të rejat që do të sjellë instituti në treg, si dhe parashikimin e mbijetesës së tij në kushtet e ekzistencës së konkurrencës së lirë në treg;
- d) ka vlerësuar planbiznesin e paraqitur dhe konstaton se ai është real dhe bindës;
- e) ka vlerësuar mundësinë e aksionarëve të propozuar të institutit për të shtuar kapitalin, në qoftë se do të jetë i nevojshëm për të mbuluar humbjet, që mund të rezultojnë nga ushtrimi i veprimtarisë si institut pensionesh;
- f) ka shqyrtuar transparencën e burimeve dhe të strukturës së kapitalit aksionar të institutit; g) ka vlerësuar strukturën organizative dhe ambientet e shërbimit të institutit të propozuar;
- h) është siguruar se pjesëtarët e bordit drejtues dhe të stafit ekzekutiv të institutit privat të pensioneve suplementare të propozuar, janë të aftë profesionalisht;
- i) ka vlerësuar dhe ka verifikuar opinionet e dhëna nga publiku për kërkesën e paraqitur;

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e paraqitur për zhvillimin e veprimtarisë si institut privat pensionesh suplementare të llojit i hapur për subjektin IAPPSSH SHA.

2. Subjekti IAPPSSH SHA, pas dhënies së lejes, si dhe pas regjistrimit në regjistrin tregtar si shoqëri anonime, detyrohet të fillojë veprimtarinë si institut privat pensionesh suplementare brenda datës 30.9.2005.

3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Naim Hasa

VENDIM
Nr.26, datë 27.5.2005

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR PRODHIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE PËR
SHOQËRINË "FAVINA" SHPK PËR CENTRALIN E VITHKUQIT

Në mbështetje të nenit 13 pika 1 germa a të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të nenit 17 pikat 1, 2 dhe 3 të “Rregullores për procedurat e licencimit”, të miratuar me vendimin nr.27, datë 30.5.2004, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, pasi shqyrtoi dokumentacionin e paraqitur nga shoqëria “FAVINA” sh.p.k.,

VENDOSI:

1. Dhënien e licencës për prodhimin e energjisë elektrike shoqërisë “FAVINA” sh.p.k. , për centralin e Vithkuqit me kapacitet 780 kW, për një afat 5- vjeçar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.27, datë 27.5.2005

PËR MIRATIMIN E FORMULARIT STANDARD TË PARAQITJES
SË NJË ANKESE NË ERE

Në mbështetje të nenit 9 pika 3 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike” dhe të vendimit nr.26, datë 13.5.2004 të Bordit të Komisionerëve të ERE-s “Rregullat e praktikës dhe procedurave të ERE-s”, neni 14, germa A pika 1, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Sektorit të Energjisë Elektrike (ERE), në mbledhjen e tij të datës 27.5. 2005, pasi shqyrtoi propozimin e paraqitur nga Departamenti i Çështjeve Ligjore dhe Marrëdhënieve me Publikun, për miratimin e formularit standard të paraqitjes së një ankese në ERE,

VENDOSI:

1. Të miratojë formularin standard të paraqitjes së një ankese në ERE, i cili i bashkëlidhet rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s.

2. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.28, datë 24.6.2005

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE PËR
KOMPANINË PUBLIKE TË GJENERIMIT

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2005, pasi

shqyrtoi draftin për metodologjinë e llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit, të hartuar nga Task-Forca e ngritur dhe nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

1. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave për kompaninë publike të gjenerimit (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.29, datë 24.6.2005

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2005, pasi shqyrtoi draftin për metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike, të hartuar nga Task-Forca e ngritur dhe nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

2. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shpërndarjes së energjisë elektrike (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.30, datë 24.6.2005

PËR MIRATIMIN E METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË TARIFAVE TË SHITJES TE KLIENTËT TARIFORË

Në mbështetje të neneve 9 dhe 28 pika 1, të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2005, pasi shqyrtoi draftin për metodologjinë e llogaritjes së tarifave të shitjes te klientët tariforë, të hartuar nga Task-Forca dhe nga Departamenti i Tarifave dhe Çmimeve,

VENDOSI:

3. Miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifave të shitjes së klientëve tariforë (Metodologjia bashkëlidhur këtij vendimi).

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.31, datë 24.6.2005

PËR SHFUQIZIMIN E VENDIMIT NR.6, DATË 23.5.2002 “PËR PROCEDURAT E VENDORJES DHE RISHIKIMIT TË ÇMIMEVE NË KOMPANITË E LICENCUARA”

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.6.2005,

VENDOSI:

1. Shfuqizimin e vendimit nr.6, datë 23.5.2002 të Këshillit Drejtues të ERE-s “Për procedurat e vendosjes dhe rishikimit të çmimeve në kompanitë e licencuara”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM
Nr.32, datë 18.7. 2005

PËR ZBATIMIN E RREGULLAVE TË MIRATUARA NGA ERE PËR FATURIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE DHE KRYERJEN E SHËRBIMEVE NDAJ KONSUMATORIT

Bordi i Komisionerëve të ERE-s në mbledhjen e datës 18.7.2005 mbi bazën e programit të miratuar nga kryetari i ERE-s në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe të disa ankesave të bëra nga konsumatorët për sasinë dhe mënyrën e faturimit të energjisë elektrike, mori në shqyrtim relacionin dhe aktin e kontrollit të ushtruar nga Departamenti i licencave dhe Monitorimit dhe Departamenti i Çmimeve dhe Tarifave në KESH sh.a. (Zona e shpërndarjes elektrike, Tiranë), dhe pas diskutimit të anëtarëve të tij për pjesën e kontrolluar të kësaj zone, arriti në këto konkluzione:

Në zonën e Tiranës nuk janë instaluar matës tek 30 888 abonentë ose 16 % në 192 426 abonentë gjithsej. Është e ndjeshme mungesa e matësve për konsumatorët familjarë, por janë akoma edhe 2326 abonentë privatë (biznese) të pakompletuar me matës. Në raportimet e mëparshme të KESH sh.a., sipas sistemit të informacionit periodik të miratuar nga ERE, në fund të muajit mars 2005 rezultojnë 13 620 abonentë pa matës ose 56 % më pak nga sa ka zbuluar kontrolli i ERE-s. Në 18.536 abonentë familjarë objekti i kontrollit nga ERE, rezulton se për 74 % të tyre është zbatuar sasia mujore e faturimit aforfe e vendosur nga ERE ndërsa për 3441 abonentë faturimi është bërë për sasinë 800 kWh në muaj dhe për 1315 abonentë faturimi është bërë për sasinë 1200 kWh në muaj nga 600 kWh në muaj që ka qenë përcaktuar sipas vendimit të ERE-s nr.48, datë 21.10.2004 KESH sh.a. (Zona e shpërndarjes elektrike Tiranë) nuk ka zbatuar në asnjë rast vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.15, datë 11.3.2005 “Për kompensimin e konsumatorëve ndaj të cilëve nuk janë zbatuar vendimet e ERE-s për vlerat e faturimit aforfe”. Faturimi aforfe është bërë në mënyrë arbitrare dhe

mbi baza subjektive nga personeli përkatës. Cilësia e shërbimit ndaj konsumatorëve, në lidhje me transparencën për leximin e matësit, dërgimin e faturës dhe dhënien e një përgjigjeje të shpejtë për ankesat e konsumatorëve, nuk është vlerësuar si duhet nga personeli i ngarkuar.

Në mbështetje të neneve 8 pika 2, germa b, ç dhe g, 9, 26 pika 1, 52 dhe 64 germa c të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, Bordi i Komisionerëve të ERE-s

VENDOSI:

1. KESH sh.a., për 3441 abonentë, të cilëve u ka bërë faturim mujor aforfe 800 kWh, nga 600 kWh në muaj të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s të bëjë menjëherë kompensimin e plotë të sasisë së energjisë elektrike të faturuar më tepër.

2. KESH sh.a., për 1315 abonentë, të cilëve u ka bërë faturim mujor aforfe 1200 kWh, nga 600 kWh në muaj të miratuar nga Bordi i Komisionerëve të ERE-s të bëjë menjëherë kompensimin e plotë të sasisë së energjisë elektrike të faturuar më tepër.

3. KESH sh.a. të dënohet me gjobë në shumën 300 000 (treqindmijë) lekë.

4. Ngarkohet KESH sh.a. për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Shkodër, me vendimin nr.384, datë 9.3.2005, vendosi shpalljen të vdekur të shtetasit Mehmet Hasan Reçaj, i datëlindjes 20.2.1962, lindur në Gruemirë dhe banues në Shkodër.

VENDIM (i shkurtuar)

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Dibër, me vendimin nr.200, datë 14.6.2005, vendosi shpalljen të zhdukur të shtetasit Arben Muda, i datëlindjes 1.1.1997, lindur në Sanxhak, Krujë.

Fletorja Zyrtare gjendet:

Duke u abonuar për çdo vit pranë:

- çdo njësie postare të qyteteve;

- Qendrës së Publikimeve Zyrtare:

Bulevardi Zhan d'Ark, pranë ish-ekspozitës "Shqipëria Sot".

Tel: 042 555 63; 267 468

Për çdo lloj informacioni, shihni faqen e internetit në adresën:

www.legjislacionishqiptar.gov.al

Pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare mund të gjeni:

BOTIMET:

1. KUSHTETUTA (edhe anglisht)
2. KODI I PROCEDURËS CIVILE
3. KODI I PROCEDURËS PENALE
4. KODI PENAL
5. KODI I PUNËS
6. KODI I FAMILJES
7. KODI CIVIL
8. KODI RRUGOR DHE LIGJI PËR TRANSPORTIN
9. KODI ZGJEDHOR (i azhurnuar)
10. KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE
11. DISPOZITA ZBATUESE TË KODIT RRUGOR

PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI:

1. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PËRMBARIMIT
2. PËRMBLEDHJE E LEGJISLACIONIT NË FUSHËN E PROKURIMIT PUBLIK
3. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR NËPUNËSIN CIVIL
4. PËRMBLEDHJE LEGJISLACIONI PËR SISTEMIN E DREJTËSISË
5. PËRMBLEDHJE NË FUSHËN E TAKSAVE DHE TATIMEVE

DOLI NGA SHTYPI:

TREGUESI KRONOLOGJIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

TREGUESI TEMATIK I LEGJISLACIONIT SHQIPTAR 1990-KORRIK 2004

Doli nga shtypi më 21.7.2005

Tirazhi: 4300 copë	Formati: 60x88/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2005

Çmimi 150 lekë